

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date 15.11.2022, lidhet kjo Kontrate Shitje Kuotash (ne vijim, "**Kontrata**") midis paleve te meposhtme:

- **Z. Luan Alijaj**, shtetas gjerman, lindur me 28.12.1982, ne ZLOPEK-SO PEC, mbajtes i leternjoftimit me numer: L86MHCZKJ (ne vijim, "**Shitesi**");

dhe

- **Idlir Themeli**, shtetas shqiptar, lindur me 13.07.1984, ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me numer personal I40713103J (ne vijim, "**Bleresi 1**");
- **Mirela Baholli**, shtetase shqiptar, lindur me 15.06.1984, ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me numer personal I45615057W (ne vijim, "**Bleresi 2**")
(Bleresi 1 dhe Bleresi 2, ne vijim, se bashku referuar si "**Bleresit**").

Shitesi dhe Bleresit, ne vijim, se bashku referuar si "**Palet**" dhe veçmas si "**Pala**".

Meqenese:

- A. Shitesi dhe Bleresit jane ortake te shoqerise "**FACT MDP**" **Shpk**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar, te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit, me numer unik identifikimi te subjektit (NUIS): M11606031A, me seli ne adresen: "*Kastrati Hotels & Tower, Zona Kadastrale 8160, Nr.Pasurie 7/58, Sheshi Italia, Tirane, Shqiperi*" (ne vijim, "**Shoqeria**");
- B. Shitesi dhe Bleresit zoterojne, secili, nga 1 (nje) kuote ne kapitalin e Shoqerise. Kapitali i Shoqerise eshte 300 (*treqind*) Leke;
- C. Shitesi deshiron t'i transferoje Bleresve te gjithe kuoten e tij, me vlere nominale 100,02 (*njeqind presje zero dy*) Leke, e cila perfaqeson 33,34% (*tridhjete e tre presje tridhjete e kater perqind*) te kapitalit te Shoqerise (ne vijim, "**Kuota e Shitesit**");
- D. Secili nga Bleresit deshiron te bleje 1/2 (*nje te dyten*) e Kuotes se Shitesit;
- E. Per sa parashtruar ne germen "A" deri "D" me siper, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

BAZUAR NE SA ME SIPER, Palet bien dakord me kushtet dhe afatet si vijon:

Neni 1

Transferimi i kuotes

- 1.1 Sipas kushteve te percaktuara ne kete Kontrate, Shitesi i transferon Blereseve, kuoten qe ai zoteron ne kapitalin e Shoqerise (Kuota e Shitesit, siç tregohet ne germen "C" me siper), te lire nga çdo barre ose pretendim ligjor i te treteve mbi te.

- 1.2 Shitesi i shet, secilit Bleres, 1/2 (*nje te dyten*) e Kuotes se Shitesit; Konkretisht si vijon:
- 1/2 (*nje e dyta*) e Kuotes se Shitesit, e barabarte me 50,01 (*pesedhjete presje nje*) Leke, i transferohet Bleresit 1, kundrejt pageses se çmimit te percaktuar ne nenin 2 te kesaj Kontrate; dhe
 - 1/2 (*nje e dyta*) e Kuotes se Shitesit, e barabarte me 50,01 (*pesedhjete presje nje*) Leke, i transferohet Bleresit 2, kundrejt pageses se çmimit te percaktuar ne nenin 2 te kesaj Kontrate.
- 1.3 Ne vijim te transferimit te Kuotes se Shitesit tek Bleresit, kapitali i Shoqerise do te zoterohet nga ortaket si vijon:
- (i) **Idlir Themeli**, shtetas shqiptar, lindur me 13.07.1984, ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me numer personal I40713103J, zoterues i 1 (nje) kuote, ne kapitalin e Shoqerise, me vlere nominale 150 (*njeqind e pesedhjete*) Leke, e cila perfaqeson 50% (*pesedhjete perqind*) te kapitalit te Shoqerise;
 - (ii) **Mirela Baholli**, shtetase shqiptar, lindur me 15.06.1984, ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me numer personal I45615057W, zoteruese e 1 (nje) kuote, ne kapitalin e Shoqerise, me vlere nominale 150 (*njeqind e pesedhjete*) Leke, e cila perfaqeson 50% (*pesedhjete perqind*) te kapitalit te Shoqerise.

Neni 2

Çmimi dhe menyra e pageses

- 2.1 Kuota e Shitesve i transferohet Bleresve (siç percaktohet ne nenin 1 te kesaj Kontrate) kundrejt nje çmimi te barabarte me vleren nominale te saj, te barabarte me 100,02 (*njeqind presje zero dy*) Leke (ne vijim, "**Çmimi**").
- Çmimi i paguhet Shitesit, ne menyre te barabarte, nga secili Shites, njekohesisht me nenshkrimin e kesaj Kontrate.
- 2.2 Pronesia mbi Kuoten e Shitesit kalon tek Bleresit ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate.

Neni 3

Deklarata dhe garanci te Shitesit

- 3.1 Shitesi eshte zoterues i kuotes qe transferohet, e cila eshte e lire nga çdo barre apo pretendim i te treteve mbi te, dhe ka te drejte ta transferoje ate siç parashikohet ne kete Kontrate.
- 3.2 Nenshkrimi i kesaj Kontrate nga ana e Shitesit nuk eshte ne konflikt apo kundershtim me ndonje marreveshje apo detyrim tjeter te Shitesit.

Neni 4

Deklarata dhe garanci te Bleresve

Nenshkrimi i kesaj Kontrate nga ana e Belresve nuk eshte ne konflikt apo kundershtrim me ndonje marreveshje apo detyrim tjeter te secilit prej tyre dhe/ose te dyve se bashku.

Neni 5

Konfidencialiteti

Secila nga Palet detyrohet te ruaje konfidencialitetin ne lidhje me permbajtjen e kesaj Kontrate, kushtet e saj, si dhe çdo informacion tjeter qe Palet kane shkëmbyer ose qe jane vene ne dijeni gjate negocimeve per nenshkrimin e kesaj Kontrate.

Neni 6

Dispozita te pergjithshme

- 6.1 Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, çdo komunikim ne baze te kesaj Kontrate duhet te kryhet me shkrim nepermjet postes se regjistruar si dhe te dergohet paraprakisht nepermjet faksit, ne adresat e seciles Pales, te treguar ne fillim te kesaj Kontrate.
- 6.2 Komunikimet konsiderohen te kryera ne menyre te vlefshme ne momentin e marrjes se letres rekomande nga marresi sipas menyres se percaktuar me siper.
- 6.2 Palet bien dakord te shlyejne secila per llogari te saj shpenzimet qe lindin ne lidhje me kete Kontrate, perfshire edhe shpenzimet ligjore per avokatet, si dhe ato qe lindin gjate negocimeve, pervec shpenzimeve te nevojshme per formalizimin dhe regjistrimin e transferimit te kuotes.
- 6.3 Asnje ndryshim i kesaj Kontrate, i dispozitave te saj ose doreheqje nga nje prej dispozitave te kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem/e vlefshme per Palet nese nuk eshte kryer me shkrim dhe eshte nenshkruar nga te dyja Palet. Doreheqja nga nje dispozite e Kontrates ose nga nje e drejte qe rrjedh nga kjo Kontrate nuk do te konsiderohet si doreheqje edhe nga dispozitat e tjera te kesaj Kontrate, pervec kur eshte thene shprehimisht ne aktin e doreheqjes. Ne rast se njera nga Palet heq dore nga nje e drejte qe i jepet ne baze te kesaj Kontrate, kjo nuk do te konsiderohet si heqje dore perfundimtare nga kjo e drejte, por si nje heqje dore e vlefshme vetem per rrethanen ne te cilen heqja dore eshte verifikuar.
- 6.4 Çdo nen, dispozite, seksion, paragraf apo nen-ndarje e kesaj Kontrate qe eshte ose do te shpallet i pavlefshem/ e pavlefshme ose te paefektshme, do te hiqet nga Kontrata, nuk do te zbatohet dhe nuk do te ndikojë, ne asnje menyre, ne vlefshmerine e dispozitave te tjera te kesaj Kontrate, ne kufinjte e parashikuar nga dispozitat ligjore.

6.5 Titujt e neneve dhe te paragrafeve te perdorura ne kete Kontrate do te konsiderohen vetem per efekte referimi dhe nuk do te perdoren me qellim interpretimin e kesaj Kontrate.

Neni 7

Ligji i zbatueshem dhe zgjidhja e mosmarreshjeve

- 7.1 Kjo Kontrate rregullohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 7.2 Te gjitha mosmarreshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate do te shqyrtohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Shitesi

Luan Alijaj
Luan Alijaj

Luan Alijaj

Bleresi 1

Idlir Themeli
Idlir

Idlir Themeli

Bleresi 2

MIRELA BAHOLLI
Mirela Baholli

Mirela Baholli